



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, me 20 shkurt 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Hydajet Hyseni, Berat Luzha, Fatmire Berisha, Džezair Murati, Ramadan Gashi, Besa Gaxherri dhe Radmilla Vujoviq.

Munguan: Suzan Novoberdaliu, dhe Ismet Beqiri.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës 21. 01. 2009
3. Shqyrtimi i Rregullores së Kuvendit
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 21. 01. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 21. 01. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rregullores së Kuvendit

Kryesuesi - Ju e dini se kemi punuar në Batllavë. Grupi nuk ka mundur të takohej që t'i diskutonte disa çështje që i kemi pasur. Për këtë ju kërkoj falje. Kanë ardhur disa vërejtje edhe nga Grupi Parlamentar i AKR-së. Çka mendoni, a do të punojmë sot si Komision, apo si grup të mbledhemi t'i shqyrtojmë këto çështje dhe t'ia paraqesim Komisionit.

Suzana Novoberdaliu - Propozoj që si grup të mbledhemi edhe një herë javën e ardhshme. Nëse është e nevojshme do të mbledhemi disa herë radhazi, pastaj çështjet t'ia paraqesim Komisionit.

Besa Gaxherri – Edhe unë mendoj se duhet të mbledhet grupi. Pastaj si Komision ta përmbylim shqyrtimin e Rregullores. Nëse sot punojmë në këtë mënyrë, do të humbim shumë kohë dhe s'do të mund t'ia dalim si duhet.

Kryesuesi – Do të thotë se po pajtoheni që grupi fillimisht t'i shqyrtojë çështjet. Java që vjen do të jetë intensive për grupin. Pas kësaj Rregullorja t'i dërgohet Komisionit. Mund të ndodhë që në fillim të marsit ta mbajmë edhe një mbledhje pune, në mënyrë që përfundimisht ta përmbylim shqyrtimin.

5. Të ndryshme

Kryesuesi - Për këtë pikë i kam disa çështje të ngutshme për diskutim, njëra ndër to është temë vizita në Shqipëri. Kam menduar se deri sot do ta kemi një agjendë konkrete, por ende nuk është bërë. Kisha dashur ta shqyrtonim këtu: A do të shkojë nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar, që të mos shkojmë si delegacion i madh, sepse mikpritësi i përballon shpenzimet. Komisioni ynë duhet të jetë në nivel. A jeni dakord për këtë propozim?

Hydajet Hyseni – Mendoj të mos e bëjmë rregull që në delegacion të jetë vetëm përfaqësimi partiak, sepse padrejtësisht dëmtohet grupit parlamentar, që ka më shumë anëtarë. Duhet ta kemi parasysh se deputetët janë të barabartë, pra të mos diskriminohen, për shkak se i përkasin një grupi më të madh parlamentar.

Besa Gaxherri – Pajtohem se secili deputet i ka të drejtat e barabarta. Megjithatë vizita në Shqipëri bëhet në harmoni me protokollin dhe me agjendën e shtetit të Shqipërisë që na ka ftuar. Kryetari i Komisionit ka kompetencë të vendosë për përbërjen e delegacionit. Me gjithë këtë më demokratike është të përfaqësohen të gjitha grupet parlamentare.

Kryesuesi – Sa i përket udhëtimit në Shqipëri, atë do ta organizojmë në koordinim me Kuvendin e Shqipërisë. Për këtë do t'ju informojmë me kohë. E kam dhe një çështje tjetër. Meqenëse buxheti është ndarë për komisione, mendoj që si Komision ta punësojmë një asistent, në mënyrë që puna e komisioneve të jetë sa më efikase.

Hydajet Hyseni – Ideja që Komisioni ta ketë një asistent është e mirë. Vetëm nuk e di se a duhet të realizohet kjo në linjën buxhetore të Komisionit, apo në një linjë tjetër buxhetore, sepse kur e llogaritim pagën, një shumë e mirë e këtij buxheti shkon për Komisionin.

Kryesuesi – Për këtë çështje kam biseduar edhe me sekretarin. Ai më ka thënë, meqë Kuvendi nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, ju si Komision keni të drejtë ta bëni. Qysh në fillim të legjislaturës e kam shtruar këtë kërkesë, por nuk është realizuar.

Besa Gaxherri – Mendoj se duhet të hartohet një projektbuxhet për këto 10 mijë euro. Sa i përket propozimit tuaj për një asistent, nuk mendoj se parashihet në këtë linjë buxhetore. Nëse nuk mund ta marrim një asistent, propozoj që së paku administratës së këtij komisioni, t'i ndahet një shumë për kartela të telefonisë mobile, sepse edhe ashtu administrata paguhet shumë pak. Për dallim nga komisionet e tjera na dërgojnë edhe *sms*. Përkundër pagave të vogla që i kanë me të vërtetë shërbejnë si duhet. Pra duhet ta shqyrtojmë bashkë dhe të vendosim se ku do t'i shpenzojmë këto mjete.

Kryesuesi – Bashkë me administratën do të propozojmë të planifikohet ky buxhet dhe të shohim sa do të na përkrahë Kuvendi për një asistent. Të gjitha do t'i trajtojmë së bashku.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit për
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të
Punës të Kuvendit

Ahmet Isufi